

AKT - THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGËTARE "TRUFFLE PG IMP-EXP" sh.p.k.

Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" krijohet shoqëria tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar **TRUFFLE PG IMP-EXP" sh.p.k.** me aktin themelues të saj si vijon:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar **"TRUFFLE PG IMP-EXP" sh.p.k.** me themeluesit:

1- Z. Lulzim ÇAMI i biri i Agron dhe i Ilmije, i datëlindjes 27.10.1969, lindur në Pogradec me nr. personal letërnjoftimi G91027098D dhe banues në Bucimas, Pogradec

SELIA E SHOQËRISË

NENI 2

Selia e shoqërisë tregëtare private adresën **Lagjja Çameria Nr.17 Bucimas, Pogradec;**



Ajo mund të çelë edhe adresa sekondare të tjera, përfaqësime dhe agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit. Të gjitha këto me vendim të ortakëve themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- Import Export, mbledhje dhe tregëti të kerpudhave ,tartufit dhe produkte të ndryshme të ndodhura në natyrë.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të hap objekte prodhimi, njesi shërbimi dhe tregëtimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jete me një afat të pa caktuar mbi 10 vjet. Shoqëria mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkak.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke, dhe zotërohet nga ortakët si më poshtë:

- **Lulzim ÇAMI** zotëron 100% të kapitalit në vlerë 100.000 lekë e barabartë me 1 kuotë

NENI 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t'ua ketë ofruar për blerje ortakut brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që i'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

NENI 9

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje **"TRUFFLE PG IMP-EXP"**, Import export niptin e shoqërisë, Pogradec, Albania

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- **Asambleja e Ortakeve** përbërë nga:
1- Z. Lulzim ÇAMI

- **Administratori i Shoqërisë** do të jete **Z . Lulzim ÇAMI** me një afat 5-vjeçar me të drejtë ripërsëritje
Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

NENI 11

Administrator i shoqërisë **"TRUFFLE PG IMP-EXP"**, është **Z. Lulzim ÇAMI** i biri i Agron dhe i Ilmije i datëlindjes 27.10.1969, lindur në Pogradec dhe banues në Bucimas, Pogradec .

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale.



NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim Ortakeve në përpjestim me kontributin e tyre në kapitalin themeltar, mbasi të jenë likujduar të gjitha detyrimet dhe të jetë hequr fondi i rezervës ligjore.

NENI 14

Ky akt u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë.

Akti u përpilua në tre kopje me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit, zyrën noteriale, tatim - taksa dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

ORTAKU I VETEM

I SHOQËRISË "TRUFFLE PG IMP-EXP", SH.P.K

LULZIM ÇAMI



Pogradec me 01.11.2021